



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 6654/Prot.

Tiranë, më 21/10/2020

URDHËR

Nr. 356, Datë 21. 10 2020

“PËR
HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT, NOTERES
GRETA NAÇO”

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 6, të nenit 7 pikës 2 të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të pikës 1, germës “ë” të nenit 21 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”, në zbatim të Urdhrit nr. 151, datë 27.05.2010, ka filluar hetimi disiplinor ndaj Noter Greta Naço, e cila ushtron veprimtarinë e saj në Bashkinë Lushnje, me objekt administrimin e të dhënave mbi ankesën e shtetases Elsa Gorreja.

KONSTATOJ:

Referuar Urdhrit nr.151, datë 27.05.2010, në datë 01.06.2020, grupi i kontrollit u paraqit në adresën e deklaruar nga noter Greta Naço, për ushtrimin e veprimtarisë noteriale. Nga verifikimet, rezultoi se zyra noteriale e deklaruar nga notere Greta Naço, në adresën Lagjia “Çlirimi”, Rruga “Qemal Stafa”, Lushnje, për ushtrimin e veprimtarisë noteriale, nuk u gjend. Gjithashtu u kontaktua në numrin e telefonit 069211045, të deklaruar nga ana e noteres, por numri ishte jo disponibël.

Nga verifikimi në QKB, notere Greta Naço rezulton me status aktiv. U vijua me verifikimin në sektorin e Arkiv Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë, nëse është paraqitur njoftim/kërkesë, për ndryshim adrese ose pezullim aktiviteti, të përkohshëm ose të përhershëm nga ana e noteres, **por nuk rezultoi asnjë kërkesë apo informacion dërguar nga notere Greta Naço.**

Në mungesë të informacionit paraprak, nëse noterja ka ndryshuar adresën e ushtrimit të veprimtarisë noteriale, ose ka pezulluar (përkohësisht ose në mënyrë të përhershme) veprimtarinë noteriale, u procedua në datë **03.06.2020**, me dërgimin e një njoftimi në adresën elektronike gretanaco@hotmail.com, të deklaruar nga ana e saj, në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë noteriale.

Në datë **09.06.2020**, nëpërmjet adresës elektronike znj.Naço na njoftoi se: “Në muajin Shkurt 2020 është larguar jashtë shtetit për arsye shëndetësore. Për arsye të bllokimit ndërkufitar të krijuar nga situata e pandemisë Coronavirus i është pamundësuar kthimi në Shqipëri. Sapo të kthehet në përfundim të situatës së pandemisë, do na njoftojë me shkrim për rikthimin, duke na informuar në

mënyrë të detajuar. Në lidhje me hetimin administrativ të nisur ndaj saj, në lidhje me ankesën e znj. Elsa Gorreja ka kthyer përgjigje me shkresën e datës 23.09.2019 dhe me shkresën e datës 06.01.2020, duke i dërguar praktikat e plota noteriale”.

Në vijim, në datë **16.06.2020**, pas kërkesës për informacion me objekt *“Mbi të dhënat e noteres Greta Naço”*, drejtuar Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe Degës Vendore Vlorë, nga ana e Degës Vendore Vlorë na u komunikua që noterja nuk ka kryer asnjë njoftim mbi pezullimin e përkohshëm ose afatgjatë të aktivitetit.

Gjithashtu në datë 18.06.2020, në vijim të kërkesës për informacion me të njëjtin objekt kërkesë, drejtuar Dhomës Kombëtare të Noterisë, është kthyer përgjigje nga Kryetarja znj. Mimoza Sadushaj, ku shprehen se, nuk ka njoftim nga noterja Greta Naço, për ndryshim adrese apo njoftim të ndonjë lloji tjetër.

Në këto kushte, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë vlerësoi se, duhej kërkuar prezenca e një përfaqësuesi të Dhomës së Noterisë Vlorë në një verifikim të dytë në terren (inspektim) në Lushnje, në adresën e deklaruar nga ana e noteres, pasi zyra nuk u identifikua në adresën e deklaruar.

Në datë 29.06.2020 ku u mbajt edhe procesverbali përkatës, grupi i punës së bashku me përfaqësuesen e caktuar nga e Dhoma e Noterisë Vlorë, znj. Saimira hoxha u paraqit në adresën e zyrës së noteres, ku u konstatua përsëri se noterja nuk ndodhej në zyrën e saj, si dhe ambienti i deklaruar si vend ushtrimi i aktivitetit në adresën Lagjja “Çlirimi”, Rruga “Qemal Stafa” Lushnje, nuk ishte zyra e noteres por e Avokatit Jurid Sharka.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 18, të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, parashikohet se, *“Noteri ka të drejtë të kërkojë që licenca e tij të pezullohet përkohësisht, për arsyt e mëposhtme: a) për shkaqe shëndetësore, të provuara nga vërtetimi i gjendjes shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi. Në pikën 2, të këtij neni parashikohet se, “Kërkesa për pezullimin e përkohshëm të licencës i drejtohet Ministrisë të Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës dhe përmban kohëzgjatjen e periudhës së pezullimit”.*

Nuk rezulton që noterja Greta Naço të ketë përmbushur parashikimet ligjore në fuqi, duke njoftuar Ministrinë e Drejtësisë mbi pezullimin e aktivitetit për shkaqe shëndetësore apo shkaqe të tjera të përligjura.

Gjithashtu, grupi i punës konstatoi se zyra e noteres nuk gjendej në adresën e deklaruar, ku sipas pikës 4, të nenit 17, të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, parashikohet se, *“Përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, në rastet e ndryshimit të vendndodhjes së zyrës noteriale ose të dhënave të tjera të shënuara në Regjistrin e Noterisë, noteri ose zëvendësnoteri njoftojnë me shkrim Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën brenda 15 ditëve nga fillimi i veprimtarisë në adresën e re ose ndryshimit të fakteve të përfshira në Regjistrin e Noterisë”.*

Në zbatim të nenit 22, të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, Ministri i Drejtësisë kryen mbikëqyrjen e veprimtarisë së përgjithshme të noterëve, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë ligj si

dhe referuar pikës 2, të nenit 25, parashikohet se, *“Ministri i Drejtësisë, në rastet kur e sheh të nevojshme, urdhëron inspektime të posaçme”*.

Në këto kushte, vlerësohet se jemi në kushtet e braktisjes së detyrës nga ana e noteres Greta Naço.

Rezulton se, notere Greta Naço nuk ka përmbushur detyrimet e parashikuara në nenin 63, pika 1, gërma “m” ku citohet se, *“Noteri, përveç detyrave të tjera të parashikuara në këtë ligj dhe në ligje të veçanta, kryen detyrat e mëposhtme...siguron mbajtjen hapur të zyrës noteriale, sipas rregullave të miratuara për këtë qëllim”*. Gjithashtu, në pikën 3, të këtij neni, parashikohet se, *“Për raste të tjera, kur noteri nuk ka zëvendës dhe mungon më tepër sesa 10 ditë, ai lajmëron me shkrim Dhomën, nga e cila merr konfirmimin e njoftimit”*.

Gjithashtu, me shkresën nr. E-96/5 prot., datë 30.09.2020, i është përcjellë për njohje noteres Greta Naço, raporti i hartuar nga grupi i kontrollit sëbashku me konkluzionet, duke i lënë 10 ditë kohë për të përcjellë kundërshtimet edhe argumentet mbi raportin. Me shkresën nr. G-40 prot., datë 06.10.2020, noterja ka përcjellë kërkesë për heqje dorë nga profesioni i noterit, për shkaqe personale.

Për sa më sipër, referuar pikës 1, gërmës “ë” të nenit 21, të ligjit 110/2018 “Për Noterinë”, ku parashikohet se: *“Heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit bëhet me urdhër të Ministrisë së Drejtësisë, kur noteri... nuk ushtron veprimtarinë noteriale për një periudhë kohe deri në 60 ditë rresht pa shkak të arsyeshëm, të dokumentuar dhe të njoftuar me shkrim pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Ministrinë e Drejtësisë”*, për këtë arsye:

URDHËROJ:

1. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterës Greta Naço, anëtare e Degës Vendore të Noterisë Vlorë, pasi nuk ka përmbushur parashikimet ligjore në fuqi, duke njoftuar Ministrinë e Drejtësisë mbi pezullimin e aktivitetit për shkaqe shëndetësore apo shkaqe të tjera të përligjura.
2. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a) Znj. Matilda Hoxha, Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - b) Znj. Ina Papa, Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - c) Një noter i caktuar nga Dega Vendore e Noterisë, brenda 7 ditëve nga marrja dijeni e këtij Urdhri.
3. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterës Greta Naço, nga Komisioni i caktuar në pikën 2, të këtij urdhri.
4. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Gjykatat e Shkallës së Parë dhe Apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.
5. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në

regjistrat noterialë, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.

6. Arkivi noterial të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Vlorë dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë.

7. Dhoma e Noterisë Vlorë, brenda 7 ditëve nga marrja dijeni e këtij Urdhri, të përcjellë emrin e noterit për marrjen në dorëzim të arkivit, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 "Për noterinë".

8. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit, pas administrimit të emrit të noterit, sipas pikës 7, të këtij Urdhri, merr masa për dorëzimin me procesverbal të arkivës noterit të përcaktuar nga dhoma përkatëse e noterisë, brenda 7 ditëve pune.

9. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.

10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

ETILDA GJONAJ (SALIU)

Konceptoi: A. Arizaj
Pranoi: E. Palnikaj
Miratoi: A. Shek
Konfirmoi: G. Deva
Nëpërmjet: K. Karameta
7 kopje/Datë: 13.10.2020